

VENDIM
Nr.171, datë 29.3.2006

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.315, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DHËNIEN ME QIRA TË PASURIVE TË NDËRMARRJEVE, TË
SHOQËRIVE DHE TË INSTITUCIONEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.315, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të shkronjës “a” të pikës 5 të kapitullit I, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Pasuritë në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare jepen me qira prej saj, për një afat deri në një vit, pa kufizim për sipërfaqen e tyre.”

2. Në fund të kapitullit III “Përcaktimi i çmimit dysheme”, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:
“6. Tarifat minimale të qirasë mujore të pasurive, në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të jenë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, për mjediset e Pallatit të Kongreseve, me miratim të ministrit, që mbulon ekonominë, aplikon tarifa më të ulëta se ato të parashikuara në këtë vendim.”.

3. Në fund të pikës 1 të kapitullit V “Shpërndarja e të ardhurave”, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Të ardhurat, që krijohen nga dhënia me qira e pasurive, në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, të përdoren nga kjo drejtori, për të mbuluar shpenzimet e veta.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA E TARIFAVE E QIRASË MUJORE NË ADMINISTRIM TË DREJTORISË SË
SHËRBIMEVE QEVERTARE

Tarifat minimale mujore të vilave e të objekteve të jenë:

Nr.	Vilat dhe objektet	Njësia e matjes	Me pajisje	Pa pajisje	Bodrum	Kopësht	Garazh
1.	Super kategori	lekë/m ²	1 800	1 500	300	150	
2.	Kategori ekstra	lekë/m ²	700	500	150	150	
3.	Kategori I	lekë/m ²	600	400	150	150	
4.	Kategori II	lekë/m ²	500	300	150	150	
5.	Kategoria III	lekë/m ²	400	200	150	150	
6.	Kategoria IV	lekë/m ²	200	150			200

Tarifat minimale të qirasë të mjedisëve për Pallatin e Kongreseve të jenë:

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Tarifat pa TVSH
I	Dhënie zyrash me qira		
A	Me pajisje	lekë/m ² /muaj	2 000

B	Pa pajisje	lekë/m ² /muaj	1500
II	Dhënie sallash me qira për 8 orë (1 ditë)		
A	Salla e koncerteve ditë aktiviteti	lekë	450 000
B	Salla e koncerteve ditë përgatitore	lekë	112 500
C	Salla e kinemasë për 1 ditë	lekë	80 000
D	Salla me përkthim për 1 ditë	lekë	100 000
E	Salla e vogla për 1 ditë	lekë/orë	45 000
F	Konferencë shtypi minimumi 1 orë		13 500
III	Dhënie hollesh me qira për 8 orë (1 ditë)		
A.	Holli kuota 0	lekë/m ² /ditë	100
B.	Holli kuota 1	lekë/m ² /ditë	300
C.	Holli kuota 2	lekë/m ² /ditë	250
D.	Holli kuota 3	lekë/m ² /ditë	250